



**INSTITUTI I STATISTIKAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Nr. 371/Prot., datë 07.06.2021
/2



**AGJENCIA E STATISTIKAVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLA DA - GOVERNMENT
ZYRA E QEVERISIAZIT - UJER PRIMEJERIA - OFFICE OF PRIME MINISTER
AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS - AGJENCIA ZA STATISTIKU KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS



Nr. _____ Prot., datë 07.06.2021
Nr./Br./No 04-052-255
Nr. fq./Br.str./No.pg 1/1
Data/Datum/Date: 07.06.2021
PRISHTINE/PRISTINA/PRISTINA

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

INSTITUTIT TË STATISTIKAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (INSTAT)

dhe

AGJENCISË SË STATISTIKAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (ASK)

Tiranë, Qershor 2021

Sot më datë _____ 2021 lidhet kjo Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Palëve:

Instituti të Statistikave të Republikës së Shqipërisë (INSTAT)

dhe

Agjencisë së Statistikave të Republikës së Kosovës (ASK)

Duke qenë se Palët:

Njohin faktin që kjo Marrëveshje përbën shprehje të vullnetshme të qëllimit midis palëve nënshkruese për të punuar së bashku për të promovuar efikasitetin e njohurive.

Synojnë që Marrëveshja të mbështesë një sërë aktiviteteve, të promovojë vendosjen e objektivave, procedurave të bashkëpunimit të ndërsjellë për shkëmbimin e pikëpamjeve dhe përvojës, në mënyrë që të lehtësojë zhvillimet dhe zbatimin e aktiviteteve statistikore.

Vlerësojnë se Marrëveshja krijon një kornizë dhe kushte të përgjithshme për bashkëpunimin efikas.

Marrin në konsideratë që Marrëveshja do të promovojë sjelljen profesionale në përputhje me Kodin e Praktikave të Statistikave Europiane dhe do të ofrojë një forum për shkëmbimin e përvojave midis dy vendeve.

Afirmojnë vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të kësaj Marrëveshje.

Kanë rënë dakord të lidhin këtë Marrëveshje bashkëpunimi në vijim të quajtur Marrëveshje.

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj Marrëveshje mes Palëve konsiston në vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve Institutit të Statistikave të Republikës së Shqipërisë (INSTAT) dhe Agjencisë së Statistikave të Republikës së Kosovës (ASK) për realizimin e bashkëpunimit kryesisht në shkëmbim eksperience, organizim trajnimesh, workshop-e, dhe seminare të përbashkëta.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo Marrëveshje bashkëpunimi bazohet në ligjin Nr.17/2018 “Për statistikat zyrtare”, Programin e Statistikave Zyrtare për periudhën 2017-2021 të Republikës së Shqipërisë, dhe ligjin NR. 04/L-036 “Për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës”, i ndryshuar.

Neni 3

Qëllimi

Palët bien dakort të bashkëpunojnë në:

- 3.1.Fushat statistikore të dakordësuara reciprokisht si Bujqësia dhe Mjedisi, Demografia dhe Statistikat Sociale, Cens-et, Statistikat e Biznesit, Llogaritë Kombëtare, Statistikat e Sektorit Real.
- 3.2.Shkëmbim i ekspertizës veçanërisht në çështjet metodologjike, cilësisë statistikore, si dhe çështjet infrastrukturore, organizative dhe Gjeoinformacionit.
- 3.3.Parimisht, të gjitha fushat statistikore janë potenciale për veprim në kuadër të kësaj Marrëveshje. Përzgjedhja e fushave specifike është një çështje e dakordësisë reciproke në të ardhmen.
- 3.4.Të ndërmarrin aktivitete në të gjitha format e mundshme të përshtatshme për zbatimin objektiv siç janë ndarja e praktikave më të mira, shkëmbimi i përvojës, shkëmbim ekspertësh, shkëmbim trajnerësh, trajnime të përbashkëta, asistencë në kuadër të standardizimit të procedurave.
- 3.5.Në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje, për çdo aktivitet, ose përkatësisht ndihma e ekspertëve (numri i ekspertëve, programi i punës, kohëzgjatja dhe kompensimi), do të përcaktohen nga Palët para çdo aktiviteti ose asistence.

Neni 4

Roli dhe përgjegjësitë e Palëve

Palët nëpërmjet strukturave të tyre marrin përsipër të:

- 4.1.Koordinojnë punën për zbatimin e kësaj Marrëveshje.
- 4.2.Caktojnë personat përgjegjës të specializuar për ndjekjen e zbatimit të çdo aktiviteti në kuadër të kësaj Marrëveshje dhe t’ja komunikojnë me shkrim Palës tjetër.

- 4.3. Sigurojnë mjetet teknike të nevojshme për zbatimin e aktiviteteve në kuadër të Marrëveshjes.
- 4.4. Ndjekin zbatimin e akteve ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare për sigurinë, konfidencialitetin statistikor dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe individuale për personat fizikë dhe juridikë.

Neni 5

Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga Palët dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 6.1. Mosmarrëveshjet midis palëve do të zgjidhen nëpërmjet frymës së mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.
- 6.2. Në rast se nuk arrihet zgjidhja në këtë mënyrë, atëherë Marrëveshja konsiderohet e përfunduar dhe e zgjidhur për të gjitha efektet.

Neni 7

Dispozita të fundit

- 7.1. Megjithë sa është parashikuar në nenin 5, kjo Marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë duke lajmëruar në formë të shkruar vullnetin për ndërprerjen e saj. Në këtë rast, Marrëveshja përfundon 30 (tridhjetë) ditë pas marrjes së këtij njoftimi.
- 7.2. Kjo Marrëveshje nuk është burim i krijimit të detyrimeve monetare dhe financiare ndërmjet Palëve.
- 7.3. Kjo Marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, ku të gjithë tekstet janë njëjloj të vlefshëm. Dy kopje për secilën Palë.

PËR

INSTITUTIN E STATISTIKAVE

TË SHQIPËRISË

.....
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Znj. Elsa DHULLI



PËR

AGJENCINË E STATISTIKAVE

TË KOSOVËS

.....
Zv. KRYESHEF EKZEKUTIV

Z. Ilir T.BERISHA